



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:040877

Datë: 12.11.2019

Numri i dokumentit: 00643127

P.nr. 337/2018

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi në lëndën penale PP/II.nr. 1216-7/17 të datës 24.05.2017, ndaj të pandehurit N. K. nga Suharekë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i Kodit Penal, duke vendosur sipas Aktakuzës të PTH në Prizren, në prezencën e PTH Sahide Sefa, të akuzuarit, me datën 05.11.2019 morri dhe publikisht shpalli dhe me datë 12.11.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I Akuzuari:** N. K. i lindur më 03.11.1961, me numër ....., i biri i M. K. dhe nënës Z. K. K., e gjinisë , me vendbanim në , Suharekë, Rr.B. P. Nr. 04 i gjendjes së mesme ekonomike , Martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse prej datës se pa vërtetuar e derime dt. 03.01.2017 ne shtepin e tij familje ne rrugën – 5.. B. 1..” Prizren, perfiotn nga ndonjë shërbim komunal qe furnizohet përmes rrjetit peques te rrymës apo rrjetit te shpernadrjes pa autorizimin e furnizuesit te autorizuar, ne ate emnyre qe shgtryezon energjien elektrike jashtë nejsorit elektik ne menyre direkte, ashtu qe neergjia e shpenzuar nuk eshte regjistruar me qrast ndërmarrjes se dëmtuar Keds – distrikit ne Prizren i shkakton dem material.

**Me këtë veprim, ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te Kodit Penal.**

Gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 46, 51, 52, 73, 74, të KP-së, si dhe nenit 320 te KP, dhe nenit 365 te KPP, të akuzuarit i shqipton:

**DENIM ME KUSHT**

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej tre (2) muajve, si dhe dënimin me gjobë prej 100 € të cilat dënime, nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari ne afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar, Keds-i distrikti në Prizren, që kërkesën pasurore-juridike, ta realizoj në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokurorisë Themelore nga Prizreni me aktakuzën PP/II.nr. 1216-7/17 të datës 24.05.2017, ndaj të pandehurit N. K. nga Suharekë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjatë seancës gjyqësore prej fillimi e gjerë në mbarim e ka përfaqësuar PTH në Prizren Sahide Sefa, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-së në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsytet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmbanë aktakuza, Gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 i Kodit Penal, andaj Gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetar, veprën penale nuk e ka kryer me dashje por nga pakujdesia, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori në kuptim të nenit 463 të KPP-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP-ës.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE**

**Gj y q t a r i**  
**Qemail Suka**

**KESHILLE JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykatë.